

## FAN S. NOLI

(1882-1965)

Me 13 mars 1965 vdiq Fan Stilian Noli, biri i madh i popullit shqiptar, personaliteti i shquar i kulturës dhe letërsisë sonë, një nga figurat më të ndritura politike, që nxori në shekullin XX lëvizja patriotike dhe demokratike përparimtare në Shqipëri.

Të flasësh për Nolin do të thotë të flasësh për ngjarjet vendimtare të historisë së Shqipërisë në çerekun e parë të shek. XX, për zhvillimin e kulturës dhe letërsisë përparimtare shqipe pas formimit të shtetit të pavarur shqiptar, do të thotë të flasësh për demokracinë, që jetën, energjitë dhe mendjen e vet gjeniale ia kushtoi çlirimit, ndriçimit dhe përparimit të popullit të vet.

Noli i përket brezit të patriotëve, që hyri në lëvizjen për çlirimin kombëtar, kur ajo kishte arritur fazën e saj më të lartë, brezit, të cilit i ra barra të luftojë për çlirimin e atdheut dhe për ngritjen e Shqipërisë, për organizimin e jetës së re shtetërore dhe shoqërore.

Ende i ri, në fillim të këtij shekulli, Noli le fshatin Qytezë të rrethit të Adrianopojës, ku u mësua me embëlsinë e shqipes dhe merr rrugën për t'i shërbyer atdheut të tij të dashur dhe të shumëvujtur.

Me veprimtarinë prej publicisti të talentuar, si letrar dhe orator i frymëzuar, me përpjekjet e tija prej militanti dhe organizatori të shquar të lëvizjes patriotike, si politikan dhe burrë shteti, Noli dha një kontribut të paçmuar në luftën e popullit shqiptar për fitimin e sigurimit e lirisë kombëtare, për përparimin shoqëror dhe shpirtëror të vendit. Kudo dhe gjithënjë në aktivitetin e vet të shumanëshëm ate e udhëhoqën interesat më jetësore të atdheut. Më 1908, i shtyrë nga çështja kombëtare, ai mveshi rrasën e priftit dhe i bëri predikimet e veta armë të idesë së bashkimit të shqiptarëve.

Noli i përket atij brezi të patriotëve, që, pasi kuptoi mësimin e historisë se pa shkatërruar sistemin e marëdhënies ekonomike dhe shoqërore të trashëguara prej Turqisë, nuk mund të bëhesh Shqipëria, u hodh me gjithë shpirt për të nxjerrë atdheun në rrugën e demokracisë e të progresit shoqëror. Në vitet 1921-1924, ai u radhit me vendosmëri në rrjeshtat e para të luftëtarëve për përfitjen demokratike të kombit. Me fjalën e fuqishme, logjikën dërrmonjëse dhe talentin e vet prej oratori të shquar, ai u ngrit kundra klasës në fuqi, bejlerëve dhe çifligarëve, që orvateshin të mbanin në këmbë në Shqipëri sistemin e kalbur politik dhe ekonomik, të trashëguar nga Turqia, të ruanin marrëdhëniet dhe format e organizimit të jetës shoqërore të tipit anadollak. Fjalimet dhe veprimtaria praktike që zhvilloi në këtë kohë ndihmuan në forcimin e lëvizjes demokratike. Cilësitë e shquara prej

burrë shteti, lufta e vendosur që zhvilloi kundra forcave reaksionare e obskurantiste, programi politik i avancuar, simpathia dhe popullariteti i madh që gëzonte në shtresat demokratike, e sollën shpejt atë në krye të lëvizjes masive antifeudale, e bënë një nga frymëzuesit e udhëheqësit e saj kryesorë. Si kryeministër i së parës qeveri demokratike që doli nga revolucioni demokratiko-borgjez i qershorit 1924, Noli u përpoq ta çonte zhvillimin e Shqipërisë në rrugën e demokracisë, të modernizimit dhe të pavarësisë së vërtetë politike, përkrahu lulëzimin e ekonomisë dhe kulturës.

Por ëndërra e tij e dashur, për të parë Shqipërinë një shtet «evropjan e të qytetëruar, të pasur, të qeverisur me rregull, me urdhër, me kanun, për të mirën e popullit, jo për fitimin e të huajve, as për qejfin e koxhabashëve tanë intrigantë dhe gjakpirës» nuk u realizua.

Luftën e vet kundra forcave të errësirës dhe të regresit Noli s'e pushoi as në mërgim. Ai bëri pjesë në krahun revolucionar të emigracionit politik, që u largua prej Shqipërisë pas disfatës së revolucionit demokratiko-borgjez. Pas vitit 1924 në mendimin politik e shoqëror të Nolit ngjasin ndryshime të mëdha, të cilat u shprehën në konkluzionet revolucionare, që ai nxori prej përvojës së disfatës së vitit 1924. Ai e kuptoi mësimin që i dha historia lëvizjes demokratike shqiptare, se pa u mbështetur në vegjëlinë, në punëtorët e fshatarët dhe pa u lidhur me lëvizjen çlirimtare demokratike të popujve të shtypur, nuk do të mundet kurrë të arrihet fitorja mbi forcat e errëta të vendit, kundra imperializmit dhe kolonializmit. Ky qëndrim i ri ndaj problemit të rrugëve të shpëtimit të masave punonjëse të Shqipërisë prej zgjedhës politike e shoqërore, gjeti pasqyrim në veprimtarinë që zhvilloi Noli si kryetar i Konares dhe i Komitetit të Çlirimit Nacional dhe e bëri atë të përshëndesë më 1927 me entuziazëm sukseset e arritura prej punëtorëve dhe fshatarëve sovjetikë në ndërtimin e shoqërisë së re dhe të shohë në Bashkimin Sovjetik mbështetjen e sigurtë të luftës çlirimtare të popujve të shtypur.

Noli i mbeti besnik idealit të vet demokratik revolucionar, krijimit të një Shqipërie popullore, shtet të punëtorëve dhe bujqëve, edhe pas vitit 1930, kur u largua nga jeta politike aktive dhe i u kushtua studimeve historike, muzikologjike dhe veprimtarisë krijuese letrare. Megjithëse larg atdheut, ai përshëndeti dhe përkrahu luftën çlirimtare që populli shqiptar nisi nën drejtimin e Partisë Komuniste kundra pushtuesve fashistë në vitet e luftës së dytë botërore. Te «kryetrimat që çliruan Shqipërinë nga fashistët, nga nazistët, nga bejlerët», ai pa vazhduesit e denjë të traditave të mëdha revolucionare të popullit tonë, brezin e ri të luftëtarëve revolucionarë, që mundën forcat reaksionare dhe sollën vegjëlinë në fuqi.

Krahas veprimtarisë së gjerë si militant politik, Noli punoi aktivisht edhe në lëmin e kulturës e të letërsisë. Në këto fusha ai derdhi energjitë e tija krijonjëse të pashterura, dijetë e thella e të gjera që zotëronte.

Noli ze një vend të veçantë në historinë e letërsisë shqipe. Ai është figura më e çquar e letërsisë përparimtare. Megjithëse i vogël në numër prodhimi i tij poetik hyri në fondin e artë të poezisë sonë. Noli shkroi një faqe të re në lirikën politike qytetare. Në këtë lloj

të poezisë zëri i tij kumboi me tingull të veçantë e gjithënjë origjinal. Mendimi sintetik, epitetet e forta, si formula të prera, apostrofat, që ngrenë peshë shpirtin, intonacionet oratorike-deklamative karakterizojnë krijimet e para poetike të Nolit: «Hymni i flamurit» dhe «Jepni për nënën» të përshkuara prej ndjenjës së flakët patriotike.

Në vjershat që shkroi gjatë viteve 1925-1930, si «Moisiu në mal», «Marshi i Krishtit», «Krishti me kamçikun», «Shën Pjetri në mangall» etj. në një formë origjinale, duke përdorur figura dhe motive biblike, Noli pasqyroi aspekte të ndryshme të jetës së kohës, trajtoi probleme të mprehta politike që e shqetësonin. Në këto krijime Noli rikthehet në ngjarjet e 1924-ës dhe nëpërmjet të mjekteve poetike rreh çështje të tilla të rëndësishme, si raportin në mes të metodave të dhunës dhe punës sqaruese e bindëse, qendrimin e masës karshi revolucionit dhe udhëheqësit, stigmatizon uzurpatorët dhe demagogët, dënon sjelljen prej frikacaku dhe renegati të bashkudhëtarëve të përko-hëshëm të lëvizjes revolucionare.

Në vitet e rëndë e të vështirë pas disfatës së revolucionit të 1924-ës, në mërgim, Noli, duke përmbajtur si burrë ndjenjat e hidhërimit e të dëshpërimit u ngriti monumente të përjetshëm shokëve dhe bashkëluftëtarëve të vet të ngushtë, Luigj Gurakuqit dhe Bajram Currit.

Larg në mërgim, në dhé të huaj, megjithëse i lodhur dhe i shqetësuar thellë për gjendjen tragjike të vendit nën thundrën gjakatare të klikës së urryer çifligaro-borgjeze, Noli nuk e humbi shpresën në forcat e vegjëlisë. «Rent, o Marathonomak» dhe «Anës lumenjve» janë dëshmi e besimit të patundur në triumfin e afërtë të vegjëlisë mbi tiraninë zogolliane; ato ndrisin nga optimizmi dhe ushtojnë nga vërshimi i ndjenjave dhe i shpresave të reja. Krijimet poetike të Nolit luajtën një rol të madh për gatitjen dhe formimin ideologjik të disa brezave të intelektualeve përparimtarë shqiptarë, edukuan popullin dhe rininë shqiptare me urrejtjen kundra obskurantizmit, arbitraritetit dhe çdo formë tiranie. Edhe sot e kësaj dite vjershat e tija janë një armë me vlerë të madhe edukative për rritjen e të rinjve me frymën revolucionare dhe besnikërinë e palëkundëshme ndaj çështjes së socializmit.

Një faqe të veçantë, që s'ka të krahasuar, Noli shkroi në historinë e përkthimit të thesareve të letërsisë botërore në gjuhën shqipe. Në saje të talentit dhe aftësisë së mrekullueshme për t'i hyrë në shpirt veprës artistike, ai bëri të kumbojë shqip fjala e ngjeshur me mendim të thellë dhe forcë tronditëse e Shekspirit, të buçasë sarkazma therrëse e Omar Kajamit, parodia e hollë dhe plot urti e Servantesit, të gjëmojë i fuqishëm pathosi kritik e qytetar i Ibsenit dhe të ndëgjohet e vërteta e pamëshirëshme e kuadrove realiste të Ibanezit.

Njohës i mprehtë i shoqërisë shqiptare dhe i nevojave të saja shpirtërore, ai zgjodhi nga fondi i letërsisë klasike dhe përparimtare botërore vepra që i ndihmonin popullit shqiptar të forcohesh shpirtërisht përballë së keqes, që i ra mbi krye me vendosjen e pushtetit monarkist të A. Zogut dhe të merte fuqi dhe guxim për t'u çliruar nga zgjedha politike dhe ekonomike ku lëngonte.

Noli që mjeshtër i madh i fjalës shqipe. Si me krijimet origjinale ashtu edhe me përkthimet e tija të pavdekëshme, ai e ngriti gjuhën tonë letrare në një shkallë të lartë, zgjeroi mundësitë e saj shprehe-

se, e pasuroi, duke lëruar në veprat e veta shtresat e ndryshme stilistiko-leksikore, i dha shkathtësinë dhe aftësinë të shprehi botën e ndërlikuar të njeriut, jetën reale në aspektet e saj të shumta, të trajtojë probleme dhe çështje të koklavitura të politikës, filosofisë, letërsisë, historiografisë, etj. e ngriti me një fjalë në shkallën e gjuhëve të zhvilluara, që shkruhen prej shumë shekujsh.

Pendës së Nolit i përkasin një tokë artikujsh, shkruar si hyrje për veprat që shqipëroi. Në «introduktat» gjejmë erudicionin e gjerë të Nolit; ai i njihte me rrënjë veprat më të shquara të kritikës botërore mbi autorët që përktheu në shqipet dhe, duke u mbështetur në 'to, arriti të shprehë gjykime të thella, të cilat e kanë kaluar me sukses sprovën e kohës. Në «introduktat» e veta Noli nënvizonte funksionin dhe rolin e madh të letërsisë në jetën e shoqërisë, përçonte idenë e frymës demokratike dhe përparimtare të veprave letrare, vinte në pah rëndësinë e artit realist në historinë e letërsisë botërore.

Në historinë e kulturës sonë kombëtare Noli hyri edhe si shkencëtar. Te «Histori e Skenderbeut» e vitit 1921 dhe ajo e vitit 1946 ai e çfaqti veten si historian i kalibrit të madh. Pasuria e hulumtimeve, mprehtësia e analizës së fakteve historike, argumentimi shkencor, fryma demokratike, stili tërheqës dhe i gjallë janë ato tipare që e shquajnë Nolin-historian. Në botimin e dytë të «Historisë së Skënderbeut» Noli bëri një hap të madh përpara në metodologjinë e vet, duke iu avitur konceptit materialist të historisë mbi rolin e individit dhe të masave në histori. Në vitet e fundit fushë e dashur për Nolin-artist dhe shkencëtar u bë muzika. Edhe këtu, si kudo shkëlqeu gjenia krijonjëse e tij. Libri «Bethoveni dhe revolucioni freng» u prit dhe u çmua nga personalitete të njohura të rretheve kulturore dhe shkencore të Evropës dhe të Amerikës, si kontribut me vlerë të madhe në studimin e njerit nga figurat kolosale të historisë së muzikës botërore. Edhe në këtë vepër spikatën cilësitë karakteristike të Nolit-shkencëtar: ndërgjegjja e lartë e studjuesit të vërtetë, rreptësia në shqyrtimin e fakteve e të dhënave dhe, mbi të gjithë këto, koncepti i drejtë shkencor që u shpreh në marrjen parasysh në analizën e vet të lidhjes së ngushtë në mes të jetës shoqërore dhe politike me artin.

Për kontributin e madh që dha në vitet 1921-1930 në lëvizjen demokratike antifeudale dhe sidomos për pasurimin e zhvillimin e kulturës e të letërsisë shqipe, Noli u rrethua nga dashuria dhe respekti i thellë i tërë kombit. Për afër gjysëm shekulli ai mbeti një nga figurat më të afërta e më të dashura të botës kulturore dhe letrare shqiptare. Veprat e tij kërkoheshin dhe lexoheshin me etje të pashuar, sepse në 'to njerëzit tanë gjenin dashurinë e zjarrtë për atdheun, shijonin fjalën e ëmbël e të kulluar shqipe, mësonin të urrenin tiraninë, obskurantizmin dhe çdo formë të shtypjes së popullit.

Gjithëçka bëri Noli për Shqipërinë hyri në thesarin e kulturës shqiptare e botërore. Në kujtimin e popullit tonë do të rrojë përgjithënjë fytyra e ndritur e demokratit të madh, poetit qytetar, shkencëtarit-historian, mjeshtrit të pashoq të gjuhës shqipe, kritikut, muzikologut dhe kompozitorit të talentuar, njerit nga bijt më të mëdhenj të këtij dheu.

K. B.